



Barazia gjinore në të drejta pronësore

Agjencia Kadastrale e Kosovës është duke trajtuar me kujdes të veçantë gjithëpërfshirjen në regjistrim të të drejtave mbi pronën e paluajtshme, me theks të veçantë lehtësimin e qasjes në të drejta pronësore për grupe potencialisht të marginalizuara. Kjo nisur edhe nga fakti që është vetë Kushtetuta e Republikës së Kosovës e cila garanton të drejtën për regjistrimin e pronës së paluajtshme për të gjithë pronarët pa dallim gjinie, etnie, feje apo çfarëdo ndarjesh tjetër. Ndërsa, viteve të fundit rëndësi e veçantë i është kushtuar barazisë gjinore në të drejta pronësore, respektivisht lehtësimin e qasjes në të drejta pronësore për gratë. Agjencia Kadastrale e Kosovës ka përkrahur iniciativë të ndryshme si vendore po ashtu edhe regjionale për avancim në këtë fushë, dhe si rezultat i kësaj edhe numrat e grave pronare dhe bashkëpronare në pronë të paluajtshme janë duke shënuar rritje. Si rezultat, sot në nivel shteti nga numri i përgjithshëm i pronarëve që është 537,431 pronarë, 434,701 (80,88 %) janë pronarë burra, dhe 91,999 (17,12 %) janë pronare gra. Pjesa tjetër 10,731 (2,00 %) janë persona juriudik. Agjencia Kadastrale e Kosovës është po ashtu një organ përgjegjës për mbikëqyrje të zbatimit të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2016 për

Masat e Veçanta për Regjistrim të Pronës së Paluajtshme të Përbashkët në Emër të dy Bashkëshortëve. Për këtë arsye, me datë 21 Mars në ambientet e Agjencisë është mbajtur një takim pune me ekspertëve të AKK, respektivisht kreut të AKK z. Avni Ahmeti, ekspertëve ligjorë z. Bashkim Shaqiri dhe z-nja Edona Kutllavci, zyrtarja për barazi gjinore në AKK z-nja Ibadete Rexhepi, me Kryeshafen e Agjencisë për Barazi Gjinore z- njën Edi Gusia edhe ekspertin për barazi gjinore z-njën Leonora Sylejmani. Tema kryesore e takimit ishte rreth ndikimit që Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2016 për Masat e Veçanta për Regjistrim të Pronës së Paluajtshme të Përbashkët në Emër të dy Bashkëshortëve. Në takim u prezantuan statistikën dhe përqindjet e grave pronare në nivel shteti, u identifikuan sfidat me të cilat ballafaqohen gratë si rezultat i mos posedimit të pronës, benefitet nga një pronë e regjistruar në kadastrë e ngjashëm. Për fund, duke marrë për bazë se udhëzimi i sipërpërmendur administrativ skadon në muajin Prill 2019, u trajtuan edhe mundësitë për zgjatjen e ligjshmërisë së këtij udhëzimi edhe për një vit. Vlen të potencohet se Agjencia Kadastrale e Kosovës në të kaluarën ka implementuar një varg projektesh për avancimin e të drejtës së gruas në pronë.

Iniciativa të AKK-së për avancim të të drejtës së gruas në pronë

**Më shumë se udhëheqësi-
(Ang. Grater than leadership")**

Programi njëvjeçar ka pasur për qëllim të ndihmojë institucionet në krijimin e strategjive dhe zgjedhjen e rrugëve të duhura për avancimin e gruas në të drejtën pronësore. Pjesë e këtyre ekipeve të përkrahura nga Banka Botërore, të krijuara në tërë regjionin, ishte edhe ekipi nga Kosova i cili është i përbërë prej 5 anëtarëve, përfaqësues të institucioneve dhe organizatave të ndryshme në fushën e administrimit të tokës, sundimit të ligjit, barazisë gjinore, etj. Republika e Kosovës ishte fokusuar në të drejtën e gruas në pronë të përbashkët duke iu referuar Ligjit për Barazi Gjinore, Ligjit të Trashëgimisë dhe Ligjit të Familjes. Pilot projekt është përqendruar në qytetin e Shtimes dhe qëllimi ka qenë që edhe gruaja të përfitojë në këtë të drejtë, sikurse burri. **(vazhdon në faqe 2)**



Gjatë projektit të Rindërtimit të Informacioneve Kadastrale (RIK) në Krushë të Madhe AKK ka angazhuar ekspertë ligjor, me qëllim të përkrahjes së grave të Krushës për përgatitjen e dokumenteve në ndarje të trashëgimisë. Fillimisht janë mbajtur disa tryeza të rrumbullakta me qëllim të informimit të grave të Krushës nga ekspertet e AKK-së për procedurat e regjistrimit të pronës, qëllimin e projektit RIK në Krushë dhe të drejtat e tyre për pronën dhe trashëgiminë të cilat janë të parapara me ligj. Gjatë takimeve, gratë shprehën interesim për tu informuar sa më mire rreth procedurave ligjore të bartjes së trashëgimisë nëpërmjet Gjykatës. Po ashtu ato përfituan edhe nga zyrtarizimi i pjesës grafike pa pagesë.



RECAP +

Shpesh, gratë në zonat rurale nuk kanë pasur kanal të komunikimit për të adresuar shqetësimet e tyre në lidhje me të drejtat pronësore, ose nuk kanë pasur mundësi që të vizitojnë ZKK-të. Po ashtu edhe mungesa e informimit për të drejtat e tyre pronësore të garantuara me ligj kanë bërë aë gratë të ndihen të marginalizuara. Me qëllim të përkrahjes dhe informimit të kësaj kategorie të lartpërmendura, Agjencia Kadastrale e Kosovës në bashkëpunim me shoqatën e juristëve NORMA, ka realizuar pilot projektin RECAP +. Studimi është kryer në 10 zona kadastrale (Istog, Likoshan, Skenderaj, Vushtrri, Grabovci i Epërm, Malishevë, Suharekë, Shtime, Kaçanik dhe Seqishtë), ku janë angazhuar 8 konsulentë, kryesisht juriste, të cilët kanë shkruar derë më derë dhe i kanë njoftuar qytetarët për ligjet aktuale të cilat garantojnë të drejtat të barabarta si për burrat ashtu edhe për gratë.

Adresat, komponentë e rëndësishme për regjistrim të popullsisë



Agjencia e Statistikave të Kosovës në kuadër të mbarëvajtjes së aktiviteteve të saja, respektivisht parapërgatitjeve për regjistrimin e popullsisë në vitin 2021, është duke bashkëpunuar me institucione të ndryshme të interesit përfshi edhe me Agjencinë Kadastrale të Kosovës si administratore, prodhuese dhe shpërndarëse ndër më të mëdhatë të të dhënave gjeohapësinore. Për këtë arsye, me datë 26 mars, në ambientet e AKK-së është mbajtur takim mes kreut të AKK-së z. Avni Ahmetit, u.d Drejtorit të Drejtorisë për Kadastër z. Korab Ahmetaj dhe ekspertës ligjore në AKK z-njës Edona Kutllavci dhe z. Avni Kastrati, Drejtor i Departamentit të Statistikave Sociale dhe Ramiz Ulaj, Drejtor i Departamentit të MTI-së pranë ASK-së. Qëllimi i takimit ishte informimi më në detaje rreth sistemit të unifikuar të adresave, mundësive më të sigurta dhe sakta për shpërndarjen e adresave përmes ueb shërbimeve dhe rreth produkteve tjera kadastrale, pronësore dhe hartografike që do të mund të ndihmonin procesin e regjistrimit të popullsisë të cilin Agjencia e Statistikave e Kosovës parasheh ta implementojë gjatë vitit 2021. Në takim z. Ahmeti prezantoi gjendjen e adresave në Republikën e Kosovës, Komunave që kanë implementuar në

tërësi sistemin e adresave, sfidat me të cilat AKK ballafaqohet gjatë implementimit të sistemit të adresave e ngjashëm. Po ashtu, përfaqësuesit e AKS u informuan edhe rreth avancimeve që i janë bërë Sistemit të Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovës, Sistemin e Unifikuar të Ueb Shërbimeve Kadastrale e ngjashëm. Palët në fund të takimit erdhën në përfundim që takime të tilla duhet të vazhdojnë edhe në të ardhmen, ndërsa si përfitues nga një bashkëpunim i tillë do të ishin institucionet dhe qytetarët e Republikës së Kosovës.

Informata mbi AKK

AKK është organ kompetent për kadastër, për mirëmbajtjen e regjistrave pronësorë, për hartografi, për sistem të adresave dhe infrastrukturë të të dhënave gjeohapësinore

KRYESHEF EKZEKUTIV
Avni Ahmeti
Avni.Ahmeti@rks-gov.net

DREJTORI LIGJOR
Ismet Kryeziu
Ismet.Kryeziu@rks-gov.net

DREJTORI I FINANCAVE
DHE ADMINISTRATËS
Fazile Hamiti
Fazile.Hamiti@rks-gov.net

DREJTORI I TEKNOLOGJISË SË
INFORMACIONIT
Afërdita Thaçi
Afërdita.Thaci@rks-gov.net

DREJTORI I KADASTRËS
Korab Ahmetaj
Korab.Ahmetaj@rks-gov.net

QASJA E GRUAS NË PRONË
Ibadete Rexhepi
Ibadete.Rexhepi@rks-gov.net

QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE DHE
INFORMATA TË PËRGJITHSHME
akk@rks-gov.net

Ri-inxhinjerimi i Zyrës Kadastrale Komunale Vushtrri, inspektohen punimet



Hyn në fuqi korniza e re e punës AKK Nr. 2019/1

Në kuadër të plotësim-ndryshimeve të Udhëzimeve Administrative si dhe pas analizave, diskutimeve dhe kontrollit të kualitetit të të dhënave nga terreni, ekspertët kadastral dhe ligjor të Agjencisë Kadastrale të Kosovës kanë ardhur në përfundim se duhet bërë avancimi edhe i Kornizave të punës të AKK-së, me qëllim të plotësimin të nevojave teknike, ligjore e profesionale për regjistrimin e pronës në kadastrë. Rrjedhimisht, me qëllim të avancimit të kryerjes së punëve kadastrale nga Zyrat Kadastrale Komunale, nga gjeodetët e licencuar dhe kompanitë e licencuara gjeodete, ekspertët e AKK-së kanë përpiluar Kornizën e re për punë Nr. AKK 2019/01 e cila rregullon standardizimin e matjeve kadastrale për krijimin e pronave të paluajtshme. Ndërsa e njëjta Kornizë pune e nënshkruan nga kreu i Agjencisë kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti me datë 29 Mars, 2019 hynë në fuqi menjëherë, duke zëvendësuar kështu Kornizën e punës Nr. AKK 2013/02 për standardizimin e matjeve dhe rievimeve kadastrale.

Duke aspiruar ngritjen e kualitetit të shërbimeve të cilat Zyrat Kadastrale Komunale ofrojnë për qytetarët dhe institucionet e Republikës së Kosovës, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka trajtuar secilën mënyrë për ofrimin e ndihmës adekuate për këto zyra. Kjo është arritur si përmes investimeve në trajnime për stafin Komunal që kryen punë kadastrale po ashtu edhe përmes investimeve të drejtpërdrejta në ngritjen e kapaciteteve teknologjike dhe profesionale nëpër Zyrat Kadastrale Komunale. Së fundmi Agjencia Kadastrale e Kosovës me përkrahje të Autoritetit Norvegjez për Kadastër dhe Hartografi "Kartveket" ka financuar ri-inxhinjerimin e Zyrës Kadastrale Komunale në Vushtrri. Si pjesë e investimeve të cilat janë mbuluar me projektin e ri-inxhinjerimit të Zyrës Kadastrale Komunale në Vushtrri janë punët renovuese, sistemi i ri i nxehjes, ventilimi ri, mbrojtja nga zjarri, arkivi, orenditë, dhe pajisjet e TI-së të cilat nevojiten për të siguruar një rrjedhë efikase të punës për stafin e Zyrës Kadastrale Komunale. Objektivi i ri-inxhinjerimit është që të përmirësojë shërbimet ndaj qytetarëve dhe të përdoret organizimi i ri me zyrë pritëse/operuese dhe procedurat e standardizuara, në mënyrë që transaksionet të jenë më sistematike, efikase dhe transparente. Duke u nisur nga fakti që AKK deri më sot ka investuar në ri-inxhinjerimin e 20

Zyrave Kadastrale Komunale në territorin e Republikës së Kosovës, pritjet janë që edhe në Vushtrri të ngrihet kualiteti i shërbimeve, transparenca gjatë ofrimit të shërbimeve si dhe të përmirësohen kushtet gjatë ofrimit dhe shfrytëzimit të shërbimeve kadastrale si për punëtorët në këto zyra po ashtu edhe për qytetarët që u drejtohen atyre. Ndërsa, me datë 21 mars, me qëllim të monitorimit të aktiviteteve të përfunduara gjatë ri-inxhinjerimit në ZKK Vushtrri, kreu i Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti me bashkëpunëtorë ka vizituar Komunën e Vushtrrisë, ku së bashku me Kryetarin e Komunës së Vushtrrisë z. Xhafer Tahiri kanë vizituar zyrat subjekt i ri-inxhinjerimit. Gjatë inspektimit është konstatuar se kompania implementuese e projektit i është përmbajtur planit dinamik, ndërsa hapja ceremoniale e këtyre zyrave të reja pritet të bëhet gjatë muajit prill.



Në bazë të nenëve 4.7, 29 dhe 34.2 të Ligjit për Kadastër nr. 04/L-013 i shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 13 me datë 01.09.2011, nën 1.1, 3.7 të Ligjit mbi Themelimin e Regjistrimit të të Dëgjave mbi Pronën e Paluajtshme nr. 2002/1, 2003/13, Nr. 04/L-009 i shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 7 me datë: 10.08.2011, Agjencia Kadastrale e Kosovës nxjerr kështu:

KORNIZË TË PUNËS NR. AKK 2019/01 PËR STANDARDIZIMIN E MATJEVE KADASTRALE

Neni 1
Qëllimi

1. Kjo kornizë e punës nxirret me qëllim të zbatimit të Ligjit për Kadastër, Ligjit mbi Themelimin e Regjistrimit të të Dëgjave mbi Pronën e Paluajtshme dhe standardizimin e të dhënave që evidencohen në regjistrin zyrtar kadastral.
2. Korniza e punës Nr. AKK 2019/01 rregullon standardizimin e matjeve kadastrale për krijimin e pronave të paluajtshme.

Përfitimet nga SIKTK online

Gjatë muajit prill Agjencia Kadastrale e Kosovës fillon me publikimin e mundësisë për aplikim online për certifikata pronësie si dhe për dorëzimin e kërkesave për azhurnime në Regjistrin Kadastral duke shfrytëzuar platformën online. Secili qytetar i cili është i interesuar për të tërhequr certifikatë pronësie ose që dëshiron të aplikoj për transaksion pronësor, mjafton që të ketë qasje në internet dhe nëpërmjet ueb faqes së AKK-së do të mund të aplikojë për të realizuar këtë shërbim. Pamja e aplikacionit është kjo:

Shfrytëzuesi/ja nuk duhet të hap llogari për të realizuar këtë shërbim. Duke shënuar numrin personal, emrin, mbiemrin, datën e lindjes, komunën ku ai/ajo ka prona dhe e-mail adresën (këta parametra pastaj verifikohen me regjistrin civil), verifikohet nëse ky person ka prona në Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme. Nëse ka prona, do të gjenerohet fletëpagesa me uniref dinamik. Pala e shtyp këtë fletëpagesë dhe e bën pagesën në njërin prej bankave. Pastaj këtë dëshmi të pagesës mund ta përcjell në ZKK. ZKK-ja lejon që certifikata të përcillet në e-mailin e personit që ka aplikuar.

Mundësia e dytë e aplikacionit është aplikimi për transaksione/azhurnime në regjistra kadastral. Personat e interesuar për këtë shërbim duhet të plotësojnë të dhënat si më poshtë dhe të ngarkojnë dokumentacionin e nevojshëm për lëndët përkatëse. Zyra Komunale Kadastrale verifikon dokumentacionin dhe ka mundësi që në e-mail të informojë palën nëse ka nevojë për dokumente shtesë dhe ti përcjell atij faturën që duhet paguar ai për të realizuar këtë transaksion.

Nëse lloji i lëndës është tjetër e jo si ky më lartë që ka të bëjë me ndarje atëherë lista e dokumenteve për ngarkim nga qytetari ndryshon varësisht llojit të kërkesës. Në momentin që regjistrohet kërkesa shfaqet mesazhi si mëposhtë i cili e ndihmon palën të përcjellë rrjedhën e lëndës për të cilën ka aplikuar se në cilin hap është.

Gjurmimi i lëndës duket si kështu:

ZKK Malishevë: Rregullim i pjesës grafike

Zyra Komunale Kadastrale në Malishevë në planin e punës për vitin 2019, nga muaji janar ka paraparë rregullimin e numrave të parregullt në gjendjen grafike. Aktualisht jemi në proces të realizimit të kësaj punë dhe si rezultat i kësaj kemi vërejtur që në shumë zona kadastrale, një numër i madhe parcelave kanë numër të parregullt. Përmisimi i numrave bëhet duke u bazuar në shënimet që posedon Drejtoria për Gjeodezi Kadastrë dhe Pronë, përkatësisht planeve kadastrale dhe foto skicat. Me përfundimit e kësaj detyre kosiderojmë që do të jetë një pasqyrë me e kjo për qytetarët të cilët e vizitojnë gjeoportalin shtetëror. Ne jemi të përkushtuar që të punojmë dhe të angazhohemi në ruajtjen dhe përmisimin e të dhënave kadastrale në atë formë duke mos dëmtuar interesin askujt.

